



# PJESËMARRJA E GRAVE TË BASHKËSIVE ETNIKE NË POLITIKË

## ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2024



Zbatuar nga:



International Foundation  
for Electoral Systems



# PËRMBAJTJA

**01**

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

**02**

HYRJE

**03**

KONTEKSTI

**04**

QASJA METODOLOGJIKE

**05**

GRATË E BASHKËSIVE ETNIKE DHE PËRFAQËSIMI  
POLITIK-PROFILI DHE TRAJEKTORET

**06**

GRATË E BASHKËSIVE ETNIKE JOSHUMICË DHE  
PËRFAQËSIMI PARLAMENTAR

**07**

KONKLuzionet

**08**

REKOMANDIMET

Kjo analizë është zhvilluar në kuadër të Programit për mbështetjen zgjedhore të qeverisë së Zvicrës, zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë prezantim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorit, projektit ose realizuesit.

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Kjo analizë u krye me qëllim që të shqyrtohet pjesëmarrja e grave të bashkësive etnike në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 dhe të kuptohen sfidat specifike me të cilat ato përballen lidhur me veprimtaritë politike dhe zgjedhore. Zgjedhjet në vitin 2024 në Maqedoninë e Veriut i shënuan disa kthesa të rëndësishme, duke e përfshirë edhe zgjedhjen e gruas së parë për presidente. Megjithëse gratë të bashkësive etnike përfaqësojnë mbi 20% të popullsisë, përfaqësimi i tyre në listat e kandidatëve dhe në Kuvend është nën 9.5%.

Edhe pse shumë gra të bashkësive etnike janë aktive në politikën e nivelit të bashkësisë, ky grup i grave nuk është uniform për të gjitha grupet etnike. Gratë e bashkësive më të vogla etnike luftojnë për të paraqitur vlerën dhe rëndësinë e tyre, edhe në partitë edhe në bashkësitë e tyre. Përkundër kësaj, gratë politike të bashkësive etnike shqiptare, nëpërmjet përfshirjes së tyre në partitë më të mëdha politike, kanë arritur të marrin pozita në nivele të ndryshme të udhëheqjes dhe herë pas here kanë role drejtuese. Gratë e bashkësive më të vogla etnike ende po përballen me përjashtimin social, ekonomik dhe politik.

Në sistemin e përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura, mundësia për t'u zgjedhur në masë të madhe varet nga vendosja në vendet më të larta në listat e kandidatëve. Ligji parasheh kuota gjinore me një prag prej 40% lidhur me rregullat e vendosjes së grave në listat e kandidatëve, por kjo nuk jep garanci për paritet gjinor. Gratë shpesh vendosen në vendet më të ulëta në këto lista, ndërsa fragmentimi politik i detyron partitë më të vogla të hyjnë në koalicione, duke kontribuar në mënyrë plotësuese që kandidatet gra të mbeten prapa liderëve burra.

Dy aspekte të sistemit zgjedhor veçanërisht e pengojnë përfaqësimin e grave të bashkësive etnike nga radhët e partive më të vogla politike: formula e financimit publik, e cila e kufizon aftësinë e partive më të vogla për të rritur ndikimin e tyre politik, dhe metoda e shpërndarjes së mandateve, e cila i favorizon partitë më të mëdha lidhur me shpërndarjen e votave të tjera.

Në përbërjen e re të kuvendit tani ka më pak gra dhe përfaqësim më të vogël të dallimeve etnike. Edhe pse gratë kanë përfaqësim më të mirë nga aspekti i kufizimeve të kornizës aktuale ligjore, dominimi i burrave në politikë edhe më tej po krijon pengesa. Pa masa konkrete, pjesëmarrja politike e grave të bashkësive etnike mund edhe më tej të mbetet e kufizuar në mënyrë të konsiderueshme. Kjo gjë mund të kapërcehet përmes reformave zgjedhore, gjegjësisht përmes veprimtarive të përshtatura afirmative. Partitë më të vogla duhet të miratojnë politika për integrimin e konceptit gjinor, të përballen me dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes në bazë gjinore, dhe të mbështesin pjesëmarrjen e grave të bashkësive etnike nëpërmjet nismave të synuara të bazuara në nevoja.

Në vitin 1995, Konferenca Botërore për Gratë, e mbajtur në Pekin, tërhoqi vëmendjen për faktin se mosha, aftësia e kufizuar, statusi social dhe ekonomik, përkatësia etnike dhe rasa mund të krijojnë barriera për gratë. Ndërsektorialiteti (ndërlidhja apo ndërthurja) njeh se jeta e njerëzve është e formësuar nga identiteti i tyre, nga marrëdhëniet dhe nga faktorët socialë. Ato të kombinuara krijojnë forma të ndërthurura të privilegjeve dhe të shtypjes varësisht nga konteksti i ndodhjes së personit, si dhe varësisht të strukturave ekzistuese të fuqisë, siç janë patriarkati, ableizmi (formë diskriminimi ose paragjykimi ndaj personave me aftësi të kufizuara), kolonializmi, imperializmi, homofobia dhe racizmi [1].

Maqedonia e Veriut është një shoqëri multietnike dhe multikulturore. Prandaj, që të përcaktohet mënyra në të cilën kjo ndërthurje ndikon në përfaqësimin politik, është e rëndësishme që të miratohet qasja për vlerësimin e pjesëmarrjes politike të grave përmes këndvështrimit të bashkësisë [2]. Qëllimi i kësaj analize është që të kërkohen pengesat me të cilat përballen gratë e bashkësive etnike kur inkuadrohen në politikë dhe të jepen rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të përfaqësimit të grave nga bashkësitë etnike në bazë të njohurive të përfituara.

Kjo analizë është thurur në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të nxjerra nga dy analizat e mëparshme që janë bërë në fushën e pjesëmarrjes politike nga perspektiva gjinore në kuadër të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut, që financohet nga Qeveria e Zvicrës dhe që zbatohet nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES). [3]

[1] “Ndërsektorialiteti, Udhëzues burimesh dhe përmbledhje mjetesh” Qasje ndërsektorale në mënyrë që askush të mos mbetet pas. UNWOMEN & UNPRPD <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-01/Intersectionality-resource-guide-and-toolkit-en.pdf>

[2] “Metodat transformative hulumtuese për rritjen e ndikimit shoqëror për grupet e rrezikuara dhe pakicat kombëtare” Donna M Mertens në *International Journal of Qualitative Methods* 2021.

[3] “Pjesëmarrja e grave në proceset politike në Maqedoninë e Veriut : Një tablo e përzier për barazinë gjinore në kontekstin e zgjedhjeve lokale në vitin 2021”, IFES Maqedoni e Veriut, 2022. Përfaqësimi i grave në zgjedhje dhe në proceset politike në Maqedoninë e Veriut – Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për zgjedhjet parlamentare për vitin 2024, IFES Maqedoni e Veriut, 2023.



## KONTEKSTI

Përfaqësimi i grave në një shoqëri multietnike dhe multikulturore nuk ka të bëjë vetëm me arritjen e barazisë gjinore, por edhe me pasqyrimin e një spektri të tërë dallimesh kulturore dhe etnike të kombit. Në një vend me një numër të madh bashkësish etnike, gjegjësisht maqedonase, shqiptare, rome, turke, vllahe, boshnjake dhe serbe, përfshirja e grave nga të gjitha këto grupe ka rëndësi thelbësore për nxitjen e një peizazhi politik më të barabartë dhe më përfaqësues.

Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 tregoi se rreth 9 përqind e popullatës rezidente deklaroi se kishte prejardhje etnike të ndryshme nga ajo maqedonase apo shqiptare[4]. Në kushtet kur përbërja etnike është çështje madhore socio-politike dhe menaxhimi udhëhiqet nga parimi i përfaqësimit të drejtë, gratë politikane të bashkësive etnike, deri në nivele të ndryshme, arrijnë të depërtojnë në fushën e politikës. Përfaqësimi i tyre në listat e kandidatëve dhe si deputete në Kuvend është shumë më i vogël, në raport me numrin e tyre real dhe vendin në shoqëri.

Përfshirja sociale[5] e grave të bashkësive më të vogla etnike varion dhe është rezultat i zhvillimit historik, socio-ekonomik dhe politik të vendit. Grumbullimi i „kapitalit social” solid nga bashkësia dhe zgjedhësit është parakusht për angazhimin në politikë, përgjithësisht për gratë, dhe veçanërisht për gratë e bashkësive më të vogla etnike. Kjo është treguar si më vendimtare lidhur me gratë politikane të cilat janë aktive në rrethin patriarkal dhe në bashkësitë etnike me qëndrime më konservatore.

Edhe pse korniza ligjore dhe institucionale e vendit kanë për qëllim sigurimin e përfaqësimit të bashkësive etnike në administratën publike, megjithatë institucionet dhe korniza ligjore janë të verbëra kur është fjala për gjininë, sepse nuk i marrin parasysh aspektet gjinore dhe nuk i shqyrtojnë nevojat e ndryshme të grave dhe të burrave.

Veprimtaritë afirmative për bashkësitë etnike ndërmerren në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve, por jo në vetë sistemin zgjedhor, e gjithsesi se jo edhe për gratë e grupeve më të vogla etnike. Në sferën politike, bashkësitë më të vogla etnike shpeshherë mbështeten për partitë politike dominuese, veçanërisht gjatë formimit të koalicioneve përpara zgjedhjeve. Gratë e këtyre bashkësive të cilat aspirojnë që të kandidohen për funksion përballen me sfida të dyfishta: së pari, t’ia dalin në krye me strukturat patriarkale në kuadër të partive të tyre, e pastaj të garojnë me kandidatët, si burra ashtu edhe gra, nga partitë më të mëdha të koalicionit të cilat kanë më shumë burime në dispozicion.

Në kontekstin e përshkruar më lart, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në Maqedoninë e Veriut u mbajtën më 8 maj të vitit 2024. Vetëm gjashtë nga 62 parti politike (10 përqind), të cilat morën pjesë në zgjedhjet parlamentare, në mënyrë individuale ose si pjesë të koalicioneve, kishin lidere gra. Për herën e parë që nga pavarësia e vendit, zgjedhjet presidenciale përfunduan me zgjedhjen e gruas për funksionin më të lartë shtetëror - President i shtetit.

Kjo fitore shënon një kthesë domethënëse në drejtim të barazisë gjinore. Megjithatë, zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 nuk dalloheshin/nuk ishin më të mira nga zgjedhjet e mëparshme parlamentare dhe u shënuan me mungesën e çështjeve për barazinë gjinore në diskursin e fushatës. Përkundër ekzistimit të kuotës për gjininë më pak të përfaqësuar që nga viti 2006, gratë shpeshherë ishin vendosur në pozicionet më të ulëta në listat e kandidatëve, aq sa ligji lejon. Kjo qasje e këtillë në vendosjen e grave në listat e kandidateve rezultoi me rënie të parëndësishme të numrit të grave të zgjedhura në Kuvend. Asnjë grua nga bashkësitë më të vogla etnike nuk u zgjodh në Kuvend, ndërsa për herë të parë nuk u zgjodh asnjë përfaqësues nga bashkësia rome.

## QASJA METODOLOGJIKE

Për analizën u shfrytëzuan burime të ndryshme të dhënash parësore dhe dytësore. U bë rishikimi i plotë i legjislacionit zgjedhor, i raporteve dhe studimeve të organizatave ndërkombëtare, i shoqërisë akademike dhe organizatave qytetare[6], dhe kjo dha bazën për përgatitjen e pyetësorit për intervistat gjysmë të drejtuara. Gjithashtu, në muajin qershor të vitit 2024, u realizuan intervistat e thelluara me tetëmbëdhjetë kandidate gra për zgjedhjet parlamentare në vitin 2024, me deputetet e mëparshme nga bashkësitë etnike, po ashtu edhe me pjesëtarët e organizatave qytetare dhe me përfaqësuesit e institucioneve publike.

Që të plotësohen të dhënat cilësore të intervistave, është shkëmbyer një pyetësor anonim onllajn me gratë kandidate dhe gratë anëtare të partisë nga bashkësitë etnike. Janë marrë dhe analizuar 42 përgjigje të pyetësorit. Edhe pse numri i të anketuarve nuk paraqet mostrën përfaqësuese, përgjigjet e marra ndihmojnë për të kuptuar profilin e grave të bashkësive etnike që janë inkuadruar në politikë dhe për të analizuar trendët dhe metodat e veprimtarive të tyre brenda dhe jashtë partive politike.

Krahas kësaj, u analizuan dhe u shfrytëzuan të dhënat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për Regjistrimin e kandidatëve dhe përpunimin fletëparaqitjeve të dorëzuara[7].

Për qëllimet e kësaj analize u përdor terminologjia e mëposhtme:

- Bashkësi më të vogla etnike ka të bëjë me të gjitha bashkësitë etnike në Maqedoninë e Veriut, përveç me bashkësinë maqedonase dhe atë shqiptare.
- Parti më të vogla politike ka të bëjë me të gjitha partitë aktive politike të cilat nuk kanë më shumë se dy deputetë. Partitë e vogla politike përfshijnë një spektër të gjerë partish, ndërsa anëtarësia është me përkatësi të ndryshme etnike. Këto parti mund të jenë kryesisht maqedonase apo shqiptare, ose mund të jenë të organizuara rreth çështjeve specifike për bashkësitë e caktuara etnike, siç janë rome, turke, vllahe, boshnjake dhe serbe.

[6] Përfshirë edhe deklaratat e vëzhguesve ndërkombëtarë, raportet e BE-së për skringun dhe për përparimin e vendit.

[7] Në dispozicion në [candidate.list.sec.mk](http://candidate.list.sec.mk)

# GRATË E BASHKËSIVE ETNIKE DHE PËRFAQËSIMI POLITIK-PROFILI DHE TRAJKTORET

Gratë e bashkësive etnike që janë aktive në politikë përfaqësojnë një grup të larmishëm dhe për shkak të kësaj profilizimi i tyre është sfidues. Për këtë analizë dhe marrë në përgjithësi, gruaja politikane e bashkësisë etnike jomaqedonase është grua e martuar e moshës së mesme me fëmijë[8]. Këto gra janë qytetare aktive dhe janë të punësuar. Ky është edhe një tregues se punësimi është shtytësi kryesor për angazhimin politik të grave nga bashkësitë etnike.




Tabela 1 - Profilizimi i gruas politikane nga bashkësia etnike jomaqedonase

Një grua e bashkësive më të vogla etnike që është e përgatitur të përfshihet në politikë mund të zgjedhë një nga opsionet e mëposhtme:

- Të inkuadrohet në parti më të madhe politike [9],
- Të inkuadrohet në parti politike të bashkësisë së caktuar [10],
- Të formojë parti politike të re, ose
- Të kandidohet si kandidatë e pavarur.

Të gjitha opsionet kanë specifika të caktuara të cilat janë përmbledhur më poshtë:

## ➤ Angazhimi në parti më të madhe politike




Një numër i vogël i grave të bashkësive më të vogla etnike parapëlqejnë të inkuadronen në partitë më të mëdha politike. Zgjedhja e tyre paraprihet nga kërkimi i mundësive që të bëhet ndikim më të madh dhe të refuzohet politika e bashkësisë, ndërsa kjo konsiderohet si faktor i klientelizmit të shtuar politik. Në përputhje me paradigmen e vet të integruar fuqishëm, më vonë të zhvilluar në „Strategjinë kombëtare për zhvillimin e konceptit një shoqëri për të gjithë dhe ndërkulturalizmin”, duket se Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) ofroi hapësirë më të madhe për gratë e bashkësive etnike se sa Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI). Gratë e bashkësive etnike rrome dhe boshnjake u zgjedhën deputete si kandidatë të LSDM-së për zgjedhjet parlamentare në vitin 2020.

## **Të inkuadrohet në parti politike të bashkësisë së caktuar**

Duket se gratë më së shpeshti e përdorin këtë opsion sepse angazhimi politik zhvillohet në kuadër të partisë politike të bazuar në identitetin etnik. Partitë e këtilla kanë tendencë që të zotohen për një përfshirje dhe përfaqësim më të mirë të një grupi etnik të caktuar lidhur me të drejtat dhe/ose politikat dhe shërbimet publike. Shumica e grave të bashkësive etnike asnjëherë nuk kanë menduar që të inkuadrohen në parti e cila nuk bazohet në bashkësinë (e tyre) etnike. Angazhimi i këtillë i zakonshëm politik, megjithatë, është shënuar me shkallë të ndryshme të përfshirjes në sferën politike.

Kur bëhet fjalë për opsionin, është e domosdoshme të bëhet dallimi në raportin e madhësisë së partisë politike sepse kjo e paracakton numrin e vendeve të deputetëve, dhe përfundimisht edhe të burimeve që sigurohen sipas Kodit zgjedhor. Duke u nisur nga ajo se bashkësia e tyre është më e madhe, si dhe nga partitë politike të vendosura dhe të organizuara mirë, gratë nga bashkësia etnike shqiptare u treguan më të suksesshme (nga bashkësitë tjera më të vogla jomaqedonase) në arritjen e përfaqësimit efektiv politik të vendeve për kryetarë të komunave, vendeve për këshilltarë në pushtetin vendor, si dhe në nivelin parlamentar dhe qeveritar.

Gratë përfaqësuese të bashkësive më të vogla etnike, si anëtare të partive politike në bazë etnike nuk ishin shumë të suksesshme në depërtimin e tyre në fushën e politikës, as në Kuvend, as në këshillat lokalë. Arsyet kryesore për këtë ndërlidhen me:

-  **Disavantazhin sistemor të krijuar me Kodin zgjedhor, që i prek partitë më të vogla etnike—prej të cilave pjesa më e madhe i përfaqësojnë bashkësitë etnike.**
-  **Shumica e këtyre partive nuk përdorin kuota të brendshme gjinore që të sigurojnë përqindje fikse të grave me role liderësh.**
-  **Organizatave të grave në kuadër të këtyre partive më të vogla politike u mungon ndikimi i duhur që të marrin pjesë në mënyrë domethënëse në proceset e vendimmarrjes së partisë.**

Nga aspekti historik, anëtarët e bashkësisë turke nuk janë pjesëmarrës aktiv në politikën kombëtare, edhe përkundër asaj se janë përfaqësuar nga katër parti politike. Popullata rome, ende si një nga grupet më të rrezikuara, edhe më tej përballet me diskriminimin institucional dhe paragjykimet sociale. Ato përfaqësohen nga 15 parti politike. Bashkësia serbe, boshnjake dhe vllahe, janë të përfaqësuar me nga tre, gjegjësisht dy parti politike. Megjithatë, asnjëra nga këto parti nuk arriti të zgjedhë një grua për listat e kandidatëve për deputetë në Kuvend.

## **Të formojë një parti politike të re**

Parë historikisht, ky opsion përdoret shumë rrallë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të pavarur dhe demokratike . Megjithatë, në prag të zgjedhjeve parlamentare në vitin 2024, te bashkësia rome kohë më parë u bënë ndryshime në lidhje me përfaqësimin e tyre politik me formimin e dy partive të reja: Bashkimi i Romëve, udhëhequr nga gratë, dhe Avaja, e cila inkuadroi shumë gra në listën e saj të kandidatëve. Edhe pse asnjëra nga partitë nuk arriti të sigurojë vende deputetësh, këto zhvendosje janë të rëndësishme dhe mund të japin rezultatet pozitive në zgjedhjet e ardhshme lokale në vitin 2025.

## **Të kandidohet si kandidat i pavarur**

Pas suksesit të kandidatëve të pavarur në zgjedhjet e fundit lokale, partitë parlamentare kohë më parë e vështirësuan këtë opsion të fundit dhe vendosën që ta rritin pragun në mënyrë të konsiderueshme të nënshkrimeve për mbështetjen e kandidatëve të pavarur me miratimin e procedurës jotransparente, të kufizuar dhe të përsheptuar.[11] Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve është vështirësuar dhe duhet kohë e konsiderueshme, mjete transportimi dhe para për verifikim të notarit, ndërsa këto janë burime të cilat gratë i kanë shumë më pak se meshkujt.

Mund të konkludohet se përfaqësimi politik i grave të bashkësive etnike karakterizohet me politikë të bazuar në bashkësinë e tyre, me fragmentim numerik dhe me hendek të konsiderueshëm ndërmjet grave të grupeve më të mëdha etnike dhe bashkësive më të vogla në lidhje me depërtimin e tyre në fushën e politikës.

[11] Ndryshimet u miratuan në Kuvend më 7 mars të vitit 2024 dhe do të zbatohen në ciklin zgjedhor vijues. Që të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare, për listat e kandidatëve të pavarur më parë ekzistonte kushti që të mblidhen më së paku 1000 nënshkrime nga qytetarët që janë nënshkruar në listën e zgjedhësve në njësinë zgjedhore të dhënë. Me ndryshimet të datës 7 mars 2024, kandidatët e pavarur tashmë duhet të sigurojnë të paktën një për qind të numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore në të cilën garojnë, një rritje prej gati 300%.

# GRATË E BASHKËSIVE JOSHUMICË DHE PËRFAQËSIMI PARLAMENTAR

Maqedonia e Veriut është demokraci parlamentare ku pushtetin ligjor e përfaqëson parlamenti njëdhomësh me 120-123 vende deputetësh[12], të cilët zgjidhen me një mandat katërvjeçar. Njëzet deputetë me një mandat katërvjeçar zgjidhen drejtpërdrejt në secilën prej gjashtë njësive zgjedhore të vendit, përmes sistemit të përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura, ndërsa vendet e deputetëve shpërndahen te kandidatët sipas metodës së Dontit dhe parimit të mesatares më të lartë[13]. Gratë e bashkësive etnike[14] janë të përfaqësuara me mbi 20% të popullsisë së përgjithshme, megjithatë, prania e tyre në listat e kandidatëve për deputete është më e ulët krahasuar me përfaqësimin e tyre real në shoqëri.

## ***Efektet e pafavorshme të sistemit zgjedhor***

Parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të të gjitha bashkësive etnike është inkorporuar në zbatimin e zgjedhjeve. Në komunat ku më së paku 20% e qytetarëve u përkasin bashkësive etnike, parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të të gjitha bashkësive etnike respektohet gjatë zgjedhjes së anëtarëve të këshillave zgjedhorë nga radhët e nëpunësve shtetërorë.[15] Në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku më së paku 20% e qytetarëve flasin në gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) dhe këshillat zgjedhorë (KK) duhet ta përdorin, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetin cirilik, gjuhën dhe shkrimin të asaj bashkësie.

Krahas anëtarësimit në organet zgjedhore dhe përdorimit të gjuhës, zbatimi i parimit të përfaqësimit të drejtë është rrënjësor në procesin e vendimmarrjes të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në rastet kur propozim-vendimi ka të bëjë me interesat e bashkësisë joshumicë, para se ta vendosë propozim-vendimin për votim, çdo anëtar i KSHZ-së i cili i përket bashkësisë joshumicë ka të drejtë të kërkojë që KSHZ-ja të vendosë për këtë propozim-vendim me konsensus[16]. Kjo në masë të caktuar paraqet edhe të drejtën e vetos, dhe e pasqyron rregullin e Badenterit për shumicën e dyfishtë në Kuvend.

Lidhur me përfaqësimin gjinor, Kodi zgjedhor përfshin disa dispozita

- 30% kuotë gjinore për organet zgjedhore[17]
- Dispozita për ruajtjen e vendit të deputetit të grave të zgjedhura[18], gjegjësisht gratë e zgjedhura të zëvendësohen me deputete të listës së kandidatëve
- 40% kuota gjinore për listën e kandidatit me dy kritere për vendosjen e listës: më së paku një nga çdo tri vende deputetësh është rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar, me të paktën një vend plotësues të deputetit në çdo dhjetë vende deputetësh.[19]

[12] Tri vende deputetësh janë të rezervuara për përfaqësimin e diasporës, por, deri më tani, ato mandate nuk janë shpërndarë për shkak të zgjedhjes së formulës zgjedhore.

[13] 'Metoda e Dontit' është formulë matematikore që përdoret në sistemet e përfaqësimit proporcional, edhe pse sjell në rezultate më pak proporcionale se sa sistemet tjera për shpërndarjen e vendeve të deputetëve siç janë metodat e Hare-Niemeyer dhe Sainte-Laguë/Schepers. Edhe pse formula është treguar e efektshme me qëllim që të lehtësohet formimi i shumicës, duke siguruar kështu funksionalitetin e parlamentit, megjithatë i disfavorizon partitë më të vogla politike.

[14] Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë në vitin 2022, edhe kjo përqindje i përfshin të gjitha bashkësitë etnike jomaqedonase.

[15] Neni 21 i Kodit zgjedhor.

25 Neni 31, alineja 34.d e Kodit zgjedhor.

[16] Në përbërjen e tij në largim, KSHZ kishte vetëm 2 gra dhe nuk e respektoi kuotën ligjore të përfaqësimit gjinor.

[17] Neni 153-a i Kodit Zgjedhor parashikon "Nëse deputeti i zgjedhur nga lista e kandidatëve është grua, dhe të cilit mandati i ka përfunduar sipas njërit prej shkaqeve – dorëheqje, i dënuar për vepër penale, privim i aftësisë afariste, vdekje ose papajtueshmëri me funksionin, më pas për pjesën e mbetur të mandatit, deputet në Kuvend bëhet kandidati i radhës nga lista e grave". Rregulli i njëjtë vlen edhe për organet e vetëqeverisjes lokale.

[18] Kodi zgjedhor, Neni 64(5).



Në sistemin e përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura, kandidatët lartë në listë kanë gjasa më të mëdha që të zgjidhen. Edhe pse partitë politike dhe koalicionet i respektojnë kushtet formalisht për kuotën gjinore, ata shpesh veprojnë në mënyrën që i dekurajon gratë, zakonisht duke i vënë gratë kandidate në pozita më të ulëta, më të pafavorshme. Kjo praktikë e dyfishon pamundësinë e tyre që të zgjidhen, sepse ekziston tendencë gjatë shpërndarjes së vendeve të favorizohen listat të cilat marrin më së shumti vota, duke i dekurajuar ata me më pak vota të marra. Si pasojë e kësaj, gratë e bashkësive më të vogla etnike, të pozicionuara pafavorshëm në listë, posaçërisht dekurajohen me këtë formulë të shpërndarjes.

Më tej, vendosja e grave në pozita më të pafavorshme në listat e kandidatëve do të thotë se kuota gjinore prej 40% nuk garanton se 40% të deputetëve do të jenë gra. Kjo ishte e dukshme në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024, dhe vetëm 35% e deputetëve të zgjedhur, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, ishin gra. Deri në shtator të vitit 2024, ky numër u rrit në 38.33%, në masë të madhe për shkak të asaj që deputetët e zgjedhur ishin të emëruar në pozita të pushtetit ekzekutiv. Në rastet e këtilla, kandidati i radhës së listës e merr vendin e deputetit që është i zbratur, ndërsa në të shumtën e rasteve, zëvendësimi ishte me gra.[20] Për gratë e bashkësisë më të vogël etnike dhe të cilat janë aktive në partinë më të vogël politike, zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 rezultuan me atë që asnjëra prej tyre nuk u zgjodh për deputete.

[21] Në përbërjen e fundit parlamentare, 51 prej 120 vendeve të deputetëve në Kuvend ishin gra, me çka shkalla e përgjithshme gjinore arriti në 42.5%. Gjithsej 43 u zgjodhën për deputete në zgjedhjet e fundit parlamentare (gjegjësisht 36%), ndërsa tetë morën vend deputeti të lënë bosh nga kandidati i mëparshëm mashkull i listës, i cili ishte emëruar në funksion në pushtetit ekzekutiv.

### Mandatet - Rezultatet e para më 9 maj 2024

Partia/Koalicioni	Gjithsej deputetë	Deputete	% e deputeteve
VMRO-DPMNE <sup>[20]</sup>	58	23	39.66
LSDM <sup>[21]</sup>	18	7	38.89
BDI <sup>[22]</sup>	19	5	26.32
VLEN	13	4	30.77
E majta	6	1	16.67
ZNAM <sup>[23]</sup>	6	2	33.33

Tabela 2 - Mandatet - Rezultatet fillestare të 9 majit 2024

[20] Koalicioni i udhëhequr nga VMRO - DPMNE - Koalicioni Maqedonia yte

[21] Koalicioni i udhëhequr nga LSDM- Koalicioni për të ardhme Europiane

[22] Koalicioni i udhëhequr nga BDI - Fronti European

[23] Koalicioni i udhëhequr nga ZNAM - Lëvizja për Maqedoninë tonë

	<b>Gjithsej deputetë</b>	<b>Deputete</b>	<b>% e deputeteve</b>
<b>GJITHSEJ</b>	120	42	35

Tabela 3 - Numri total i deputeteve femra dhe përqindja

<b>Mandatet - më 3 shtator 2024</b>			
Partia/Koalicioni	Gjithsej deputetë	Deputete	% e deputeteve
VMRO-DPMNE	58	26	44.83
LSDM	18	7	38.89
BDI	18	4	22.22
VLEN	14	6	42.86
E majta	6	1	16.67
ZNAM	6	2	33.33

Tabela 4 - Mandatet - që nga 3 shtator 2024

	<b>Gjithsej deputetë</b>	<b>Deputete</b>	<b>% e deputeteve</b>
<b>GJITHSEJ</b>	120	46	38.33

Tabela 5 - Numri total i deputeteve femra dhe përqindja

## **Efektet e pafavorshëm i Ligjit për financimin e partive politike**

Sipas Ligjit për financimin e partive politike, financimi shtetëror nga buxheti kombëtar në nivelin vjetor ndahet në bazë të dy kriterëve: 30% e shumës së përgjithshme shpërndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet të gjitha partive politike të cilat kanë siguruar së paku 1% të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare ose lokale. 70% të tjerat shpërndahen proporcionalisht në bazë të numrit të deputetëve të zgjedhur në Kuvend dhe anëtarëve të këshillave komunalë. Në sistemin e përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura, kjo metodë e shpërndarjes të mjeteve ka tendencë që t'i dekurajojë partitë më të vogla politike[24]. Në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, sa më pak mjete që pranon një parti, aq më e vogël është gjasa që këto mjete të shfrytëzohen për përforcimin e grave dhe promovimin e mundësive të barabarta në dhe jashtë partisë. Që të krijohen kushte më të barabarta, mund të merret parasysh edhe revizioni i kriterëve për shpërndarjen e financimit publik, duke siguruar se partitë më të vogla dhe gratë e tyre kandidate kanë mundësi më të barabarta të konkurrojnë në fushatë për zgjedhjet e ardhme parlamentare. Efektet e pafavorshme të Ligjit për financimin e partive politike, në kombinim me fragmentarizmin e konsiderueshëm në përfaqësimin politik të bashkësive më të vogla dhe sistemin zgjedhor i cili i favorizon partitë më të mëdha, i shtyjnë partitë më të vogla në koalicione parazgjedhore. Liderët meshkuj të partive zakonisht i mbajnë pozitativat më të larta të favorshme në listat e koalicioneve, dhe kjo efektivisht i vendos gratë në rol dytësor. Kjo dinamikë vlen edhe në koalicionet me partitë më të mëdha edhe ndërmjet partive më të vogla. Shembull i qartë për këtë është koalicioni i udhëhequr nga BDI, ku liderët meshkuj të katër partnerëve më të vegjël të koalicionit ishin përfaqësuesit e vetëm të zgjedhur nga liderët e tyre.[25]

[24] Në përbërjen e fundit parlamentare, 51 prej 120 vendeve të deputetëve në Kuvend ishin gra, me çka shkalla e përgjithshme gjinore arriti në 42.5%. Gjithsej 43 u zgjedhën për deputete në zgjedhjet e fundit parlamentare (gjegjësisht 36%), ndërsa tetë morën vend deputeti të lënë bosh nga kandidati i mëparshëm mashkull i listës, i cili ishte emëruar në funksion në pushtetit ekzekutiv.

[25] “Duke marrë parasysh se pothuajse të gjitha sistemet zgjedhore ka tendencë që t'i koncentrojnë përpjekjet në favor të partive më të mëdha kur votat e fituara duhet të përkthehen në vende deputetësh dhe mbështetja e popullit të jetë kriter kryesor i shpërndarjes, duket se do të ishte më e përshtatshme të merret parasysh numri i votave (si në Armeni, Estoni, Norvegji dhe, si kriter plotësues, në Rumani) ose si masë alternative direkte të mbështetjes së popullit, siç është anëtarësia partiake në vend të masës indirekte e cila automatikisht prodhon efekt të dëmimit të sistemit zgjedhor”. Cfr. Ingrid VAN BIEZEN, Financimi i partive politike dhe fushatat zgjedhore – Udhëzime, Projekt i integruar “Drejt institucioneve demokratike funksionale”, Këshilli i Evropës, 2003, f. 45 dhe 46. Cituar në Komisionin e Venedikut, Kodi i praktikës së mirë në planin e partive politike, cdl- ad (2009) 021, paragrafi 163.

[26] Lëvizja për bashkimin kombëtar të turqve në Maqedoninë e Veriut; partia Lëvizja e Popullit, Partia Demokratike e Turqve dhe Lëvizja e Turqve të Maqedonisë për drejtësi dhe demokraci.

## Zgjedhja e kandidatëve dhe fushata zgjedhore

Për zgjedhjet parlamentare në vitin 2024, 10 parti politike dhe 6 koalicione, si dhe një grup zgjedhësish propozuan 1,770 kandidatë. 42 përqind të kandidatëve ishin gra dhe prej tyre, 8.2 % (ose 167) ishin gra kandidate nga bashkësitë etnike.

Analiza e listave të kandidatëve për dy ciklet e fundit në zgjedhjet parlamentare vërteton se partitë politike kryesisht kanë qasje numerike ndaj pjesëmarrjes gjinore, sepse asnjëra prej tyre nuk ka inkuadruar më shumë gra nga kushti minimal ligjor dhe vetëm 25% e grave kanë qenë bartëse të listës së kandidatit. Është me rëndësi se të dyja koalicionet VLEN dhe BDI, të cilat përbëhen ekskluzivisht nga parti politike jomaqedone, nuk nominuan asnjë grua si bartëse të listës së kandidatëve. Kjo tregon se dominimi mashkullor në kryesinë partiake mbetet i pandryshuar dhe se kjo ndikon në hartimin e listave të kandidatëve.

Në përpjekjen për të pasur një vështrim më të mirë të veprimtarive rreth hartimit të listave të kandidatëve dhe të zbatimit të fushatave zgjedhore, u morën informatat vijuese përmes pyetësorit onllajn.

Në të gjitha partitë politike në të cilat aderojnë të anketuarit ekziston organizata e grave, por vetëm 58% e të anketuarve janë shprehur se partitë e tyre përdorin kuota të brendshme për përfaqësimin gjinor. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve ishin kandidatët politik për herën e parë, që mund të sqarohet me njohjen e tyre relativisht të ulët të rregulloreve për kuotat gjinore dhe procesin e brendshëm të përzgjedhjes së kandidatëve në partinë e tyre. Edhe pse procesi i hartimit të listave të kandidatëve në përgjithësi ishte përshkruar si korrekt, transparent, me balancim gjinor dhe i bazuar në merita, megjithatë një e treta e të anketuarve e karakterizuan si të paqartë, të nxitur nga favorizimi dhe kryesisht me dominimin e meshkujve.




Tabela 6 - Procesi i përgatitjes së listës së kandidatëve

Gratë ndanë mendimin se nuk kanë përjetuar dhunë dhe diskriminim, si në partinë e tyre ashtu edhe në kuadër të koalicionit të tyre. Ato ishin të përfshira në lloje të ndryshme të aktiviteteve në fushatë dhe përgjithësisht nuk janë ndier se pranojnë trajtim të ndryshëm dhe mbështetje nga kolegët e tyre meshkuj. Megjithatë, u paraqitën disa raste kur ishin lënë anash gjatë fushatës zgjedhore. Në vendbanimet më të vogla, aktivitetet dhe mbledhjet më së shpeshti i kanë zbatuar meshkujt, që vërteton se në mjediset rurale është në lojë dinamika më konservatore, për dallim nga mjediset urbane.

Vetëvlerësimi i marrëdhënieve me anëtarët dhe mbështetësit e partisë nxjerr në pah se disa parti më të vogla politike ende nuk i kanë kapërcyer efektet e lënies anash të organizatës dhe faktit se nuk kërkohet bashkëpunim të plotë me organizatën e gruas.

54,8% u shprehën se marrin pjesë aktive në mbledhjet strategjike ku kërkohet mendimi i tyre ; 38,8% ishin të ftuar vetëm të marrin pjesë në mbledhje dhe të përmendim emra të caktuar, ndërsa 6,4% nuk janë takuar me kolegët e tyre meshkuj dhe mbështetësit e partisë.




Tabela 7 - Marrëdhëniet ndërmjet kandidatëve dhe anëtarëve të partive politike

Interaksioni ndërmjet partnerëve të koalicioneve sërish ofron një tablo të përzier, gjegjësisht, 33% asnjëherë nuk janë takuar me anëtarët dhe mbështetësit e partisë tjetër të koalicionit. Nga dy të tretat tjera të cilët kanë bashkëpunuar me anëtarë tjerë dhe mbështetës të koalicionit, gjysma atë e kanë përshkruar si bashkëpunim të kufizuar, ndërsa gjysma tjetër si bashkëpunim të plotë. Ekziston hapësirë për një përfshirje më të madhe të grave nga bashkësitë më të vogla, si në partitë, ashtu edhe në koalicionet të cilave ata u përkasin.

Vetëm 19% e grave që iu përgjigjën pyetësorit onllajn kanë qenë në komunikim me përfaqësuesit e mediave gjatë fushatës politike dhe pothuajse në të gjitha rastet kjo ka qenë në iniciativën e mediave. Për mediat tradicionale dhe onllajn edhe më parë është treguar se i transmetojnë dhe i përforcojnë stereotipat gjinorë gjatë përfshirjes dhe komunikimit me gratë kandidate Në anën tjetër, frika e të folurit në publik dhe frika nga keqpërdorimi onllajn si pasojë e dukshmërisë së shtuar në publik ka efekt të fuqishëm që t'i rikthejë gratë prej dukshmërisë.

Paradoksale është ajo se rekomandimet të cilat të anketuarit i kanë për gratë e ardhme kandidate e përmbajnë mesazhin e njëjtë: besoni në vetvete, flisni dhe vetëm përpara! Megjithatë, lëkundja e dukshme te gratë politikane nga bashkësitë më të vogla që të kyçen aktivisht në komunikim me gazetarët me qëllim që të përforcohen përpjekjet e tyre dhe dukshmëria në fushatë, duhet të kuptohen dhe të trajtohen më mirë. Kjo ka rëndësi thelbësore që t'u mundësohet grave kandidate të bashkësive etnike që të kuptojnë hapësirën mediatike tërësisht.




Tabela 8 - Bashkëpunimi me anëtarët e koalicionit dhe një parti tjetër politike



## KONKLuzionet

Pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 2024, nga 120 deputetë të rinj të zgjedhur në Kuvend, vetëm 11 janë gra nga bashkësitë etnike (10%), dhe 10 janë të përkatësisë etnike shqiptare. Për herën e parë, në Kuvend nuk ka përfaqësues të romëve, dhe kjo pasqyrohet edhe në numrin e ulur edhe në dallimet të grave deputete. Gratë politike të bashkësive më të vogla përballen me sfida domethënëse, duke i përfshirë edhe kuotat gjinore të kufizuara, efektin e koalicionimit, anshmërinë gjinore për pozitën drejtuese dhe shpërndarjen e pafavorshme të vendeve të deputetëve dhe të burimeve.

Këta faktorë rezultojnë me përfaqësimin e tyre të pamjaftueshëm edhe në listat e kandidatëve edhe në vendet e deputetëve. Pa masa të orientuara, pjesëmarrja politike e grave të bashkësisë joshumicë mund të kufizohet seriozisht. Edhe përkundër të drejtave të garantuara të pjesëmarrjes, bashkësitë më të vogla etnike përballen me mundësi të pabarabarta të angazhimit politik, ndërsa gratë nga këto bashkësi nuk kanë qasje të njëjtë si gratë tjera politike. Këto çështje duhet shqyrtuar me kujdes në diskutimet rrjedhëse për reformat zgjedhore.

Gratë e bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare në politikë duket se janë një hap përpara në krahasim me gratë e bashkësive më të vogla. Mekanizmat ekzistues juridikë dhe institucionalë që kanë për qëllim që të garantojnë të drejtat dhe përfshirjen shoqërore të bashkësive më të vogla – ato që nuk e plotësojnë prapësinë e përfaqësimit prej 20%- nuk përmbajnë kritere që të sigurohet përfaqësimi i drejtë i grave dhe i burimeve.

Pjesëmarrja politike e bashkësive më të vogla etnike është e penguar nga aspekte të caktuara të sistemit zgjedhor, të cilat i favorizojnë partitë që i përfaqësojnë bashkësitë më të mëdha. Këtu përfshihen shpërndarja e pabarabartë e financimit publik dhe formula e shpërndarjes së vendeve të deputetëve, me atë që të dy aspektet u japin përparësi joproporcionale grupeve të mëdha.

Përderisa të gjitha gratë politike po përballen me një shkallë të caktuar diskriminimi të drejtpërdrejtë dhe strukturor të rrënjësor në sistemin zgjedhor dhe në strukturën e partive politike të tyre, ato nuk paraqesin një grup homogjen. Dinamika e fuqisë në shoqëri e vendos përkatësinë partiake në rend të parë, përkatësinë etnike në rend të dytë dhe gjininë në rend të tretë.

Gratë e bashkësive më të vogla etnike jo vetëm që përballen me sfidat e njëjta, si të gjitha gratë politike, por edhe përballen me padëshirueshmëri plotësuese në bazë të përkatësisë së tyre etnike. Ato sfida ndikojnë në pranimin e tyre në kuadër të bashkësisë së tyre dhe më gjerë në shoqëri, e kufizojnë qasjen e tyre në arsimin sipëror dhe punësimin në sektorin publik dhe ndikojnë negativisht në pozitën brenda partisë së tyre. Si rezultat i kësaj, këta faktorë i zvogëlojnë në mënyrë domethënëse gjasat e tyre për t'u zgjedhur, që kontribuojnë për ruajtjen e përfaqësimit të pamjaftueshëm të grave të bashkësive në pozita liderësh dhe zgjedhëse.

## REKOMANDIMET

### ***Veprime afirmative dhe reforma zgjedhore: bërja e zgjedhjes së informuar***

Një qasje për t'u siguruar pjesëmarrja efektive e grave dhe e individëve të pakicave kombëtare është veprimtaria afirmative në rregullat zgjedhore. Krahas përfaqësimit të garantuar kushtetues të pakicave në Kuvend dhe /ose në komisionet e veçanta parlamentare „ Kodi i praktikave të mira i rregullave zgjedhore” të Komisionit të Venedikut i shënon parimet kryesore për zhvillimin e rregullave për veprime afirmative që harmonizohen me traditat evropiane zgjedhore. Këto parime janë:

➤ partive politike që i përfaqësojnë pakicat kombëtare duhet t'u garantohen vendet e rezervuara,

➤ pragjet zgjedhore nuk duhet ta pengojnë përfaqësimin e pakicave kombëtare,

dhe

➤ vizatimi i skemës së njësive zgjedhore (lidhur me numrin, madhësinë, formën dhe përmasat) mund të përshtatet që të avancohet pjesëmarrja e pakicave në proceset e vendimmarrjes.

Lidhur me përfaqësimin politik, edhe përkundër asaj se me normat ndërkombëtare edhe më tej nxitet formimi i partive politike në nivelin e bashkësisë, këtu mund të dallohen edhe rreziqet e fragmentimit politik dhe marginalizimit. Theksohet se pjesëmarrja e pakicave kombëtare në politikë nuk duhet të kufizohet vetëm te partitë e formuara në bazë etnike. Lidhur me partitë më të mëdha politike, dispozitat me të cilat ato detyrohen për të siguruar përfaqësimin e pakicave në komisionet brendapartiake dhe në listat e kandidatëve konsiderohet se paraqet praktikë të mirë zgjedhore.[27]

Dispozitat për vendet e rezervuara të cilat shpërndahen veças për pakicat kombëtare janë mjaft të shpeshta në rajon ( p.sh., në Shqipëri, në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Kroaci, në Kosovë, në Malin e Zi, në Slloveni, në Rumani). Edhe pse vendet e rezervuara mund të jenë mekanizëm afatshkurtër për sigurimin e përfaqësimit të pakicave në një periudhë kalimtare, në afat të gjatë, interesat e pakicave dhe vetë vendit mund të kënaqen më mirë me përfaqësimin përmes sistemit të „rregullt” zgjedhor[28].

Shpesh konsiderohet se “sa më proporcional është sistemi zgjedhor, aq më shumë i jep mundësi pakicave, madje edhe atyre të shpërndara, që të përfaqësohen në organin e zgjedhur [29]”. Prandaj, çelësi i ri i shpërndarjes së vendeve të deputetëve me të cilin „vendet tjera” u shpërndahen në bazë të njëjtë të gjitha partive të cilat do ta kalojnë pragun për hyrje në parlament, e jo me formulën e mesatares më të lartë, mund të rezultojë me shpërndarjen e mundshme të një numri më të madh vendesh të partive më të vogla dhe me këtë të rriten gjasat për gratë e këtyre partive, të cilat janë vendosur në pozita më të ulëta të mundshme në listat e kandidatëve, të zgjidhen në parlament.

[27] Komisioni i Venedikut: Pjesëmarrja e pakicave në jetën publike (“Shkenca dhe teknika e demokracisë” seria, N° 45).

[28] Në “ Përmbledhje mendimesh dhe raportesh të Komisionit të Venedikut për mbrojtjen e pakicave kombëtare (botim i plotësuar 1)”, dhjetor 2022, CDL-PI(2022)049.

[29] CDL-INF(2000)4, E drejta zgjedhore dhe pakicat kombëtare, III.B.1

Komiteti i ministrave i Këshillit të Evropës i rekomandon vendeve-anëtare që të „mendojnë për futjen e “sistemeve ziper”, gjegjësisht, të alternimit të vendeve për të dy gjinitë.”[30] Rezultati do të ishte vendosja e grave në pozita më të favorshme në listat e kandidatëve (si p.sh., sepse është momentalisht çdo vend i tretë, i gjashtë etj., do të jetë çdo vend i dytë, i katërt etj.) dhe kështu do të rriteshin gjasat e tyre për t’u zgjedhur.

Mund të shqyrtohet mundësia [31] për vendosjen e financimit publik nga aspekti gjinor në legjislacionin zgjedhor që të avancohet pjesëmarrja e grave. Sistemet që përdorin kombinimin e shpërblimit ose dënimit financiar që t’i motivojnë partitë politike për t’i dhënë përparësi ekuilibrit gjinor, do t’u mundësojnë grave, sidomos atyre të grupeve të përfaqësuara pamjaftueshëm, të kenë qasje në vendet e listave të kandidatëve për t’u zgjedhur.

Gratë e grupeve etnike duhet të informohen plotësisht për anët e mira dhe të këqija, si dhe për efektet e mundshme të opsioneve të ndryshme për përfaqësim proporcional (si për shembull, lista të hapura kundrejt lista të mbyllura, një njësi zgjedhore kundrejt më shumë njësi zgjedhore) me qëllim që të kenë kontribut domethënës në debatin për reformat zgjedhore dhe të zotohen për hapësirë të zgjeruar politike .

### ***Rritja e pranueshmërisë së grave politike të partive më të vogla politike***

Që të përmirësohet pranueshmëria e grave politike nga bashkësitë më të vogla, është thelbësore që të rritet profilizimi i tyre publik, krahas përforcimit të lidhjeve sociale dhe përforcimit të tyre ekonomik. Vetëm ndryshimi politik është i pamjaftueshëm pa ndryshim adekuat të pikëpamjeve shoqërore ndaj grave. Stereotipat tradicionalë gjinorë mund të mohohen me rritjen e dukshmërisë së grave lidere. Megjithatë, është me rëndësi të theksohen arritjet e këtyre grave në mënyrat për atë se çfarë dobie kanë për tërë bashkësinë, duke menaxhuar kujdesshëm rreziqet lidhur me shfaqjen e tyre në publik.

Për zbatimin efikas të aktiviteteve të orientuara në profilizimin dhe pranueshmërinë e rritur publike të grave politike nga bashkësitë më të vogla , është e rëndësishme që së pari të krijohet ambienti i mbështetjes nga mediat tradicionale, nga platformat onllajn dhe nga rrjetet sociale.

[30] Pjesëmarrja e grave në proceset politike në Maqedoninë e Veriut: Një tablo e përzier për barazinë gjinore në kontekstin e zgjedhjeve lokale në vitin 2021”, IFES Maqedoni e Veriut, 2022;

[31] [https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en)

## **Nënshtrimi i dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes në bazë gjinore**

Gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat të aspektit gjinor janë kërcënim për indin shoqëror dhe nuk duhet lejuar që ato ta formësojnë peizazhin socio-ekonomik. Në raportin e skringut të BE-së propozohen masa të ndryshme për tejkalimin e kësaj sfide, përfshirë edhe përforsimin e kapaciteteve të organeve për zbatimin e ligjeve dhe drejtësisë penale që të evidencojnë dhe të paraqesin rastet e krimit nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes. Lidhur me rritjen e gjuhës së urrejtjes gjatë zgjedhjeve, siç u përmend më përpara[1], partitë politike duhet të tregojnë përkushtim të vërtetë në zotimet e tyre dhe të përmbahen nga përdorimi i fushatës negative. Partitë politike, po ashtu, duhet ta moderojnë përmbajtjen e faqeve dhe kanaleve të tyre të mediave sociale.

Mediat tradicionale duhet të punojnë në rolin që mbajnë në raport me përjetësimin dhe përforsimin e stereotipave gjinorë, dhe atë përmes vendosjes së politikës redaktoriale me përfshirjen e perspektivës gjinore, bordeve redaktuese të balancuara gjinore, identifikimin dhe njohjen e gjuhës diskriminuese gjinore dhe ngritjen e vetëdijes së gazetarëve për informimin e balancuar gjinor.

Organizatat qytetare që e përbëjnë lëvizjen gjinore dhe gratë politike nga i gjithë spektri politik duhet të përgjigjen në rrethana të caktuara dhe të reagojnë me reagime të shpejta e të koordinuara duke i mbështetur personalitetet publike dhe duke shkëmbyer dhe organizuar mesazhe të cilat do të shprehin keqardhje për viktimat e gjuhës së urrejtjes onllajn dhe do t'i turpërojnë kryerësit.

Përfundimisht, në përputhje me Rekomandimin për politikë të përgjithshme të Komisionit Evropian kundër racizmit dhe mostolerancës (EKRI) nr. 15, veprimtaritë të orientuara në ngritjen e vetëdijes për pasojat e rrezikshme të gjuhës së urrejtjes te publiku më i gjerë dhe veçanërisht te popullata më e re do të mund të zbatohen për të mirën e tërë shoqërisë.

## **Barazia gjinore kundrejt mundësive të barabarta**

Komisioni Parlamentar për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave dhe Klubi i deputeteve luajnë rol kryesor për sjelljen e ligjeve me ndjeshmëri gjinore dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare të vendit për barazinë gjinore në legjislacionin kombëtar. Këto zotime duhet të vazhdojnë dhe në mënyrë plotësuese të forcohen, duke përfshirë nismat për luftën e perceptimit negativ për nismat gjinore.

Strategjia për barazi gjinore e BE-së për 2020-2025[27] e përcakton vizionin, si dhe synimet e politikave dhe veprimtarive që të arrihet përparim konkret në raport me barazinë gjinore në Evropë. Duke marrë parasysh se negociatat për aderim në BE filluan në korrik të vitit 2022, këto përpjekje japin edhe bazën për inkuadrimin e kësaj Strategjie dhe Legjislacionit gjinor të BE-së në legjislacionin përkatës kombëtar.

## Partitë politike dhe integrimi i perspektivës gjinore

Fusha e politikës edhe më tej mbetet të jetë në përgjithësi nën dominimin e burrave, ndërsa partitë politike kryesisht kanë miratuar një qasje të kufizuar numerike ndaj integritit të perspektivës gjinore, dhe deri më tani nuk u arrit që të arrihen ndryshime domethënëse. Edhe pse ky vlerësim i përgjithshëm mbetet i vlefshëm, është e qartë se partitë politike që përfaqësojnë bashkësitë etnike, kanë arritur nivele të ndryshme progresi në rrugën e integritit të perspektivës gjinore.

Kundrejt qasjes së miratuar numerike të barazisë thelbësore[28], barazia e mundësive ndërmjet grave dhe burrave mund të përforcohet në mënyrë plotësuese në drejtim të rishpërndarjes, pranimit, pjesëmarrjes dhe transformimit. Duke e pasur parasysh këtë gjë, partitë politike që i përfaqësojnë bashkësitë etnike do të mund t'i nxitnin përpjekjet për integrimin e perspektivës gjinore përmes zbatimit të masave të mëposhtme:

➤ Mënjanimi i padëshirueshmërive (dimension rishpërndarës): Partitë më të mëdha shqiptare, të cilat janë më të avancuara në promovimin e barazisë gjinore, mund të vendosin kuota të vetëimponuara, siç është "sistemi zipper," (vendeve reciproke për gra dhe burra) për listat e kandidatëve për deputetë dhe anëtarë të këshillave lokalë. Ata, gjithashtu, mund të investojnë në gratë kandidate për kryetare komunash përmes sigurimit të trajnimeve të veçanta përmes akademive të tyre partiake. Ndërkohë, partitë më të vogla mund ta vënë fokusin në vendosjen të sa më shumë grave në vende të larta në listat e tyre të kandidatëve prej nga do të zgjidhen.

➤ Ballafaqimi me stigmën, paragjykimin, stereotipat dhe dhunën (dimensioni i njohjes): në praktikë, të gjitha rastet e dhunës duhet të procedohen dhe të sanksionohen nga partia, pa marrë parasysh procedurat gjyqësore eventuale të mëtejme. Nga 62 parti aktive politike, 17 parti u nënshkruan në Kodin e sjelljes për luftën kundër dhunës ndaj grave në politikë dhe në proceset zgjedhore[29]. Partitë politike duhet ta nënshkruajnë Kodin dhe duhet t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

➤ Mundësim të pjesëmarrjes dhe dhënie zë të personave në situatë të pafavorshme (dimensioni i pjesëmarrjes): duhet të përforcohet organizata e grave në parti për të pasur rëndësi më të madhe në vendimmarrje, veçanërisht gjatë hartimit dhe vendosjes për listat e kandidatëve në parti dhe në kuadër të koalicionit.

➤ Përshtatja e dallimeve përmes ndryshimeve strukturore (dimensioni transformues): Kjo mund të sjellë iniciativat siç janë vendosja e kuotave të brendshme gjinore për të gjitha pozitat në kuadër të strukturës partiake, duke krijuar mundësi për gratë që të kenë qasje në rolet udhëheqëse. Gjithashtu, kjo mund të arrihet edhe përmes emërimit të kryetares së organizatës së grave të partisë në komisionet drejtuese partiake në shkallë kombëtare dhe vendore, dhe të shqyrtohet mundësia për vendosjen e gruas për zv/kryetare te partitë më të vogla të cilat ende nuk e kanë bërë këtë gjë.

[32] Ky Kod është pjesë e mbështetjes teknike të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve, projekt i Agjencisë zhvillimore zvicerane në Maqedoninë e Veriut, që e zbaton Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore. <https://electoralsupportprogramme.mk/wp-content/uploads/2024/04/ENG-Code-of-Conduct-Combating-violence-against-women-in-politics-and-in-the-electoral-process.pdf>

[33] Pjesëmarrja e grave në proceset politike në Maqedoninë e Veriut: Një tablo e përzier për barazinë gjinore në kontekstin e zgjedhjeve lokale në vitin 2021 ", IFES Maqedoni e Veriut, 2022; [1] [https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en)

[34] Ky Kod është pjesë e mbështetjes teknike të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve, projekt i Agjencisë zhvillimore zvicerane në Maqedoninë e Veriut, që e zbaton Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore. <https://electoralsupportprogramme.mk/wp-content/uploads/2024/04/ENG-Code-of-Conduct-Combating-violence-against-women-in-politics-and-in-the-electoral-process.pdf>

Partitë politike duhet të përpunojnë strategji informimi në drejtim të rritjes së nivelit të pranimit dhe të regrutimit të grave kandidate në zonat rurale dhe të largëta/të izoluara.

Gratë e partive më të vogla dhe të bashkësive etnike duhet të angazhohen për buxhet të destinuar në kuadër të buxhetit të partisë politike për vitin 2025, ndërsa organizata e grave e partisë duhet ta ketë në dispozicionin e vet atë buxhet. Ky buxhet mund të shfrytëzohet për veprimtari të cilat kanë për qëllim që të rritet numri i grave në listën e kandidatit të partisë dhe të mbështeten veprimtaritë e tyre në fushatë, duke i bërë më efikase, më të dukshme dhe më pak të varura nga kryesia partiake.

Partitë politike duhet të fillojnë me zotimet zhvillimore të orientuara drejt ndërtimit të kapaciteteve të grave anëtare të partisë, e veçanërisht të kandidateve për zgjedhjet e ardhme lokale. Këto përpjekje mund të bëhen në fusha të ndryshme, siç janë shkathtësitë e të shprehurit në publik (fjalime, intervista, publikime onllajn dhe tema), politika dhe shërbime publike të pushtetit lokal, kuptimin e mjeteve me destinim për fushatën zgjedhore, duke përfshirë kontaktin me mediat lidhur me reklamimin e paguar politik e ngjashëm.



Përpjekjet zhvillimore mund të zbatohen përmes programeve të mentorimit, të cilat janë strukturuar rreth takimeve, shkëmbimit të e-postës, trajnimeve, pjesëmarrjes së përbashkët në ngjarjet politike ose thjeshtësisht me parëzimin e grave të reja kandidate me gra më me përvojë apo me kolegë meshkuj.

Për gratë politike nga bashkësitë etnike, mbështetja e fuqishme dhe e pandërprerë e familjes paraqet bazë për angazhimin e tyre politik. Andaj, ndërtimi i qëndrueshmërisë së familjes kundrejt shpërdorimeve dhe shpifjeve që ndonjëherë ndodhin nga ekspozimi i shtuar në publik, mund të ndihmojë në përballimin e momenteve të vështira dhe në dhënien e mbështetjes së përhershme.